



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES
DREJTORIA E MBIKËQYRJES

Nr. 278 Prot.

Tiranë, më 09.02 2026

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 34, datë 09.02 2026

**PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES ME OBJEKT VERIFIKIMIN E ZBATIMIT
TË LIGJSHMËRISË NË APLIKIMIN E INSTITUTIT TË PËRFUNDIMIT TË
MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL PËR SHKAK TË LIGJIT, NË
INSTITUCIONET E VARËSISË TË MINISTRISË SË DREJTËSISË, PËR VITIN
2025**

Në zbatim të nenit 11, pika 1, dhe nenit 14 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ligjit nr . 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, dhe Rregullores “Për procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.3.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, të ndryshuar si dhe Vendimit nr. 82, dt. 31.12.2025, “Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2026” ,

URDHËROJ :

1. Fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me institutin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, parashikuar nga neni 65 i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, në institucionet e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë që janë pjesë e shërbimit civil gjatë vitit 2025.

Institucionet që do të përfshihen në këtë proces janë:

- a) Institucionet e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë.
 - Komiteti Shqiptar i Birësimeve;

- Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor;
- Qendra e Botimeve Zyrtare;
- Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve;
- Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit;
- Instituti i Mjekësisë Ligjore;
- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas;

b) Departamenti Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse.

2. Grupi i punës do të përbëhet nga Drejtori i Mbikëqyrjes, Altin Shumeli si dhe inspektorët Eros Hoxha dhe Granit Bajri.
3. Grupi i punës do të jetë përgjegjës për verifikimin e të dhënave të administruara dhe analizën e procedurave të ndjekura nga njësia e burimeve njerëzore dhe njësia përgjegjëse (DAP), në përputhje me përcaktimet e nenit 65, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përkatësisht :
 - Përfundimi i marrëdhënies për shkak të ligjit kur: a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; c) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë; ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit; d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
 - Do të verifikohen dhe administrohen të gjitha aktet administrative të cilat e konstatojnë ndodhjen apo njohjen e shkakut të përfundimit si akti që finalizon procesin nga: a) njësia e burimeve njerëzore e institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën; b) DAP-i, për anëtarët e TND-së.
4. Mbikëqyrja për administrimin e dokumentacionit në subjekt do të fillojë sipas përcaktimeve në programin e punës dhe do të përfundojë në datë **10.03.2026**. Nëse gjatë fazës së përpunimit të të dhënave lind nevoja për të përsëritur vizitën në subjekt, ky proces do të realizohet me kërkesën e grupit të punës.
5. Me përfundimin e këqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave, inspektori përkatës, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, do të vijojë procesin me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e projektraportit të mbikëqyrjes. Projektraporti do t’i dërgohet institucionit të mbikëqyrur për t’u njohur me gjetjet, duke i lënë 5 ditë kohë për të përgatitur observacionet.
6. Pas përfundimit të afatit për njohjen e subjektit të mbikëqyrur me raportin paraprak, grupi i punës do të hartojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku do të përfshihet

edhe analiza e observacioneve. Në datën 30.03.2026, do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur.

7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij urdhri.
8. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të njoftojë grupin e punës për këtë akt dhe të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

